



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0742**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) " BE NEW " L.L.C., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizimi me inventar shkollor për artikujt që nuk janë në AQP-Dollap metalik me numër të prokurimit 616-24-1180-1-2-1, e 07.10.2024 mori:

## **Vendim**

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE " BE NEW " L.L.C. me nr. 2024/0742 , e datës 18.08.2024, kurse vendimi i AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi me inventar shkollor për artikujt që nuk janë në AQP-Dollap metalik me numër të prokurimit 616-24-1180-1-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarrë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtrijë kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrijë kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me datë 16.02.2024 Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me inventar shkollor për artikujt që nuk janë në AQP – dollap metalik me nr. të prokurimit 616-24-1180-1-2-1. Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës për

furnizim, me vlerë të parashikuar 105,000.00€.

Me datë 01.08.2024 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 ku ka shpërblyer me kontratë OE “Europrint Group ShPK”. Me datë 03.08.2024 OE “Be New LLC” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 13.08.2024. Me datë 18.08.2024 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0742.

### **- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak -**

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

### ***Pretendimet e operatorit ekonomik ankues:***

**Pretendimi nr. 1** – *“Pretendimi i OE ankues ka të bëjë me specifikimet teknike të përcaktuara në paramasë dhe parallogari konkretisht me kërkesat: Prodhuesi i dollapëve duhet të i plotësojë këto standarde:-TestRaportin përSVHC. Pretendimi i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me Test raportin SVHC dhe përmbajtjen e tij dhe pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar test raportin në përputhje me kërkesën e paramasës dhe parallogarisë. Po ashtu pretendimi ka të bëjë edhe me OE Prime Corporation LLC, NTP Blendi, Delfina Home LLC lidhur me test raportin e dorëzuar”*.

**Pretendimi nr. 2** – *“Pretendimi i OE ankues ka të bëjë me certifikatat ISO sipas kërkesës së paramasës dhe parallogarisë - Prodhuesi i dollapëve duhet të i plotësojnë këto standarde:-ISO 9001,-ISO14001,-OHSAS 18001 Pretendimi i OE ankues ka të bëjë me certifikatat në gjuhën angleze dhe ato në gjuhën kineze. OE ankues pretendon se kompanitë e prezantuara në certifikatat në gjuhën angleze nuk janë të njëjta me ato në gjuhën Kineze”*.

**Pretendimi nr. 3** – *“Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me validitetin e sigurimit të ofertës eksperti shqyrtues sqaron se sipas FDT-se hapja e ofertave është realizuar me datën 12.03.2024. Sigurimi i tenderit është kërkuar për 120 dite që i bie deri me datën 10.07.2024. AK ka dërguar kërkesë për zgjatjen e validitetit të ofertës për të gjithë OE pjesë të aktivitetit të prokurimit me datën 26.06.2024, ndërsa kërkesë për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së sigurimit të tenderit me datën 22.07.2024. OE i rekomanduar për kontratë ka zgjatur afatin e vlefshmërisë së ofertës sipas kërkesës ndërsa validitetin e sigurimit të tenderit e ka vazhduar nga data 23.07.2024 deri me datën 20.11.2024. Si rezultat oferta e OE të rekomanduar për kontratë ka qenë pa validitet të sigurimit të ofertës nga data 10.07.2024 deri me datën 23.07.2024”*.

### **- Vlerësimi dhe administrimi i provave -**

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 20.08.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës ndërsa me datë 27.08.2024 është

dorëzuar raporti i ekspertizës nga eksperti shqyrtues.

Lidhur me ankesën është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet me rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

***Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore janë prezantuar si në vijim:***

**Lidhur me pretendimin nr. 1** – “Eksperti shqyrtues sqaron se AK përmes kërkesës për sqarim të datës 29.04.2024 ka kërkuar që të dorëzohen ISO standardet dhe test raporti SVHC sipas kërkesës së paramasës dhe parallogarise. OE i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar ISO standardet si dhe test raportin me nr. SDHL1608015763FT në emër të LUOYANG MAS YOUNGER EXPORT AND IMPORT COMPANY LTD i cili raport është për kërkesat e sigurisë (safety requirements) sipas kërkesave të standardit EN 14073 2006 i cili ka të bëjë me dimensionet, kërkesat e sigurisë dhe forcës dhe ngurtësisë së mobileve për zyre. Eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesa e paramasës ka të bëjë me SVHC (Substances of Very High Concern) që ka të bëjë me përmbajtjen kimike të produktit derisa OE i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar test për siguri fizike e cila nuk është i njëjtë prandaj testi i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontrate nuk është në përputhje me kërkesën e paramasës dhe parallogarise. Vlen të theksohet se AK gjatë kërkesës për rishqyrtim të OE ankues të datës 19.05.2024 e kishte aprovuar si të bazuar kërkesën e cila kishte të bëjë pikërisht me kërkesën e test raportit SVHC kundër OE të rekomanduar për kontrate me arsyetimin “Mbi të gjitha ky raport nuk ndërlidhet me SVHC dhe në fakt aty nuk përmendet fare akronimi SVHC apo termi përkatës në gjuhën angleze (Substances of Very High Concern). Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi ankimor është i bazuar në tërësi”. Sa i përket pjesës së pretendimit që ka të bëjë me test raportin për OE Prime Corporation, Delfin Home dhe NTP Blendi eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi është i qëndrueshëm sepse asnjëri nga OE pjesë e këtij pretendimi nuk kanë dorëzuar test raport sipas kërkesës së paramasës dhe parallogarise. Eksperti shqyrtues vlerëson se kemi të bëjmë me të njëjtin rast të cilin AK-ja në këtë rast nuk e ka trajtuar njëjtë prandaj sipas ekspertit shqyrtues AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe 59 të LPP-se dhe përkundër shfrytëzimit të nenit 59.2 dhe 70 OE i rekomanduar për kontrate nuk e ka plotësuar kërkesën sipas paramasës dhe parallogarise, rrjedhimisht pretendimi ankimor është i bazuar”.

**Lidhur me pretendimin nr. 2** – “Eksperti shqyrtues pas administrimit të provave; ofertës së OE të rekomanduar për kontrate, sqarimit të datës 29.04.2024 vlerëson se certifikatat (ISO 9001, 14001, 45001) të dorëzuara në gjuhën angleze janë në emër të kompanisë Loyang Dbin Office Furniture Co.,Ltd ndërsa dokumentet e dorëzuara në gjuhën kineze nuk janë në përputhje me nenin 13 paragrafi 2 i LPP-se dhe si të tilla nuk mund të merren në shqyrtim dhe si përfundim pretendimi ankimor nuk është i bazuar”.

**Lidhur me pretendimin nr. 3** – “Eksperti shqyrtues vlerëson se AK nuk ka vepruar në përputhje me RRPP 001/2022 gjatë vlerësimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontrate për faktin se oferta e OE të rekomanduar për kontrate nuk ka kontinuitet të validitetit të sigurimit të ofertës dhe si rezultat pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar”.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtrësi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

#### **- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -**

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit dhe janë të mbështetura edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 dhe 72 të LPP.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues. Argumentimi i ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues. Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet e OE ankues janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit

shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës të datës 03.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me inventar shkollor për artikujt që nuk janë në AQP – Dollap metalik” me nr. të prokurimit 616-24-1180-1-2-1 ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicioj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Kimete Gashi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të ushtrojë Padi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit në Gjykatës Komeriale/Departamenti për çështje Administrative në Prishtinë.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " BE NEW " L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: